



2013

RAPORT- TM₁ -2013



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A


Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hr-jugor.com

PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësish të K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	4
I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME	5
II. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	6
2.1 Aktivitetet – Janar-Mars 2013	6
2.2 Aktivitetet e Shërbimit Teknik për eliminimin e humbjeve teknike	9
2.3 Planifikimi I investimeve emergjente	9
2.4 Furnizimi me ujë të pijes në Njësitë Punuese	10
2.5 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	10
2.6 Servisimi I ujëmatësave	11
2.7 Zyra për planifikim dhe zhvillim	12
2.8 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	13
III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	14
3.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	14
3.2 Aktivitetet e shërbimit për informim	17
3.3 Pengesat në realizimin e objektivave	21
3.4 Planet për të ardhmen	21
IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV	22
4.1.1 Aktivitetet - Janar-Mars 2013	22
4.1.2 Përgjigje në padi apo revizion	24
4.1.3 Padi nga Kompania	25
4.1.4 Kërkesë e gjykatës themelore për ekzekutim	25
4.1.5 Vendimet në favor të kompanisë	25
4.1.6 Lëndë të kryera përfundimisht	25
4.1.7 Në pritje të vendimeve gjyqësore	25
4.1.8 Procedimi I lendeve ne gjykata per kundervajtje	26
4.1.9 Masat e ndermarra nga Gjykata per kundervajtje	27
4.1.10 Procedurat gjyqësore te pambaruara	27
4.1.11 Vendimet e lehuara për ankesat e konsumatoreve	28
4.2 Aktivitetet e zyrës së Teknologjisë Informativë	28

V.	RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR	31
5.1	Aktivitetet - Janar-Mars 2013	31
5.2	Shpenzimet – Janar-Mars 2013	32
5.3	Raport I performances- Shkurt-Mars 2013	33
5.4	Raport I performances- Janar-Mars 2013	38
5.5	Raport I performances- TM4-2012 - TM1- 2013	43
VI.	RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM	48
VII.	RAPORT I AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT	49
ORGANOGRAMI		
SHTESA I:	Raporti I Auditorit të Jashtëm	

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME

FURNIZIMI

Edhe pse prurjet e ujit ne burimet e vjetra me gravitet kane filluar te ken rritje por jo ne mas te duhur, fale shtimit te kapacitetve te reja te ujit te pijes tek lokacioni „40 Burimet“ kemi arritur te kemi gjendje stabile te furnizimit me uje per te gjithë qytetin e Prizrenit me regjion e sidomos për konsumatorët që furnizohen me sistem te gravitetit.

Kompania është angazhuar dhe ja ka arritur qe ne muajin Mars te vitit 2013 te furnizojë të gjithë konsumatorët me uje te pijes 24 ore ne perjashtim te zonave te larta te cilat furnizohen me sistem te pompimit ku dhe kemi reduktime te shkurtëra brenda dites (*Kryesisht Laxha Dardania*). Në Njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka pasë probleme me furnizim me uje te pijes dhe duke u bazuar ne raportet e Njesive Operuese kemi patur furnizim pa nderprerje me uje te pijes.

UJI I PRODHUAR

Për muajin Janar - Mars 2013 ne nivel regjional janë raportuar prodhim te ujit, **4,557,401.00 m³** ose **586 l/s** krahasuar me tre mujorin e fundit kemi nje renje te prodhimit te ujit te pijes **379,883,00 m³**. (-7.69%). Jane duke vazhduar aktivitetet në sigurimin e burimeve te reja te ujit te pijes, ne kaptimin e ketyre sasive te reja si dhe injektimin e kesaj sasie ne rrjetin distributiv.

FATURIMI

Nw periudhen e TM1 2013 janw faturuar 1,797,185 m3, apo 6.67% mw pakw se nw periudhen TM4 2012.

Faturimi nw Euro nw TM1 2013 ka qenw 990,822.27€, nw krahasim me TM4 2012 ka pasw njw rritje prej 0.39%

INKASIMI

Nw periudhen e TM1 2013 janw inkasuar 704,786.83€, apo 4.12% mw pakw se nw periudhen TM4 2012.

Pwrqindja e inkasimit ishte 70.48% ose -3.16% mw e ulwt se nw periudhen TM4 2012

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon te mbetet nje sfide kryesore e te gjitha sherbimeve te kompanise, ku ne bashkpunim me te gjitha sherbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve te huaj dhe vendore kemi planifikuar shume aktivitete kryesisht ne zvogelimin e UPF-se.

Kompania ne nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore per zvogelimin e UPF-se qe nenkupton parandalimin e keqpërdorimeve ne teresi dhe sanimin ne kohe te defekteve ne teresi.

Shërbimi Teknik me te gjithë sektoret e tije është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u perpjekur për sanimin e tyre sa më të shpejtë. Kompania eshte duke i vazhduar aktivitetet per zvogelimin e UPF-se dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Eshte formuar grupi i veçant brenda Depertamentit Teknik per verifikimin e rrjetit shperndares dhe verifikimin e valvulave ne qytetin e Prizrenit. Deri me tani eshte verifikuar rrjeti shperndares si dhe janë duke i berë analizat neper zonat e furnizimit.

Raportet tregojne qe UPF ne nivel regjional per tre mujorine pare te viti 2013 eshte **60,57%**. (60.56)

SHPENZIMET

Shpenzimet nw periudhen e TM1 2013 arrinw nw 756,485.32€ apo 2.70% mw tw ulëta se nw periudhen TM4 2012.

Pwrqindja e inkasimit ishte 70.48% ose -3.16% mw e ulwt se nw periudhen TM4 2012

MBULIMI OPERATIV

Mbulimi operativ pwr periudhen TM1 ishte 0.93 apo 0.02 mw e ulwt se nw periudhen TM4 2012

II. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK

2.1 Aktivitetet - Janar - Mars – 2013

- ✚ Aktivitetet e sherbimit Teknik ne nivel regjional kan qene te parreshtura dhe jane orientuar ne mundesine e furnizimit sa me te rregullt me uje te pijes per te gjithë konsumatorët qe kjo kompani i mbulon, si dhe ne aktivitetet teknike per uljen e humbjeve si atyre teknike poashtu dhe atyre administrative respektivisht uljen e vlerave te UPF-se.
- ✚ Sa i perket projektit te financuar nga K-WISER per Ujëmatës zonal Projekti ne fjale ka perfunduar plotesisht dhe pritet te perfundojne te gjitha procedurat ne menyre qe te munde te regjistrohet si aset i kompanise, si ne Malisheve, Dragashe, Suhareke dhe ne Preizren, projekt qe perfshin vendosjen e mateseve zonal, pusetat betonit, Valvula dhe fittingjet.
- ✚ Ne fshatin Lubizhde e Hasit ka perfunduar shpimi i Pusit ne thellesi prej 220[m] me crast kemi perfituar 5-6 l/s dhe eshte bere perurimi i ketije projekti. Ky projekt do te finanohet nga bashkfinancusi kuvendi komunal, perkatsisht Drejtoria e sherbimeve publike ku eshte nenshkruer i marreveshtjes me daten 13.09.2012 ne mes HRJ-Komunes dhe perfaqesuesit te fsh.Lubizhde e Hasit.
- ✚ Ne muajin Janar eshte berë hapja e dy puseve tek Filtrat, dhe eshte bere shpuarja me thellsi 110metra dhe tjetri puse eshte shpuar 115 m. ku do te krijohet nje lidhje me sistemin e shperndarjes se ujit neper mjet filtrave ku nje pjes e qytetit do te furnizohet nga keto dy puset.
- ✚ Takim me perfaqesusin e Komunes se Mamushes per realizimin e projektit per shpimin te puseve si dhe vendosjen e trafos per furnizim me energji elektrike, si

dhe nga perfaqsi i komunes se Mamushes jemi informue se TIK-u ka zotuar shumen prej 90.mije euro per kete projekt.

- ✚ Eshte berë hulumtimin e ujit te pijes në komunen e Malisheves për shpimin e pusit dhe percjelljen e ujit per fsh.Drenovcë dhe është berë një paralogaritje e shumes se perafërt, si dhe kan filluar shpimet nga ana e komunes se Malisheves
- ✚ Hapja e pesë puseve tek 40 burimet me thellësi perafersisht nga 50 metra si dhe janë krijuar lidhjet me qellim per te furnizuar me uje terë qytetin e Prizrenit, dhe keto puse sjellin nje sasi te ujit prej afersisht 110 l/s.
- ✚ Nga Departamenti Teknik jane plotesuar dokemntacionet e nevojshme per Pelqimet-Lejet perkatese te cilat jane derguar ne MMPH dhe ne Komunen e Prizrenit per projektin Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujerave te Zeza. Pasi qe lidhur me lejet përkatëse për ndërtimin e ITUZ-se , janë dy institucionet përgjegjëse.
- ✚ Ministria përgjegjëse për çështjet mjedisore që lejon projektimin, sistemin dhe shkallën e procesit të trajtimit, dhe Komuna e Prizrenit e cila per rehabilitimin dhe ndertimin e dy kolektoreve si dhe ndërtimin e ITUZ-se do të jep lejen përkatëse.
- ✚ Nga komuna e Prizrenit jemi ne procedure te rregullimit te dokumentacionit perkates, ku ne Drejtorine e Sherbimeve Publike eshte leshuar nje pelqim per mundesine e manovrimeve teknike te cilat kane te bejne me projektin, kurse nga Drejtoria e Urbanizimit jane leshuar Kushtet urbanistike te cilat duhet te plotesohen per te na u mundesuar Leja perkatese. Sa i perket MMPH edhe pse para 5 muajve eshte dorezuar kerkesa per dhenien e pelqimit perkates ende nuk kemi marre ndonje pergjegje nga kjo ministri.
- ✚ Eshte mbajtur takimi me grupin e eksperteve per Strategjine Kombetare te investimeve ne sektorin e ujit te pijes dhe ujerave te zeza,
- ✚ Takim me ekspertet e minjeres dhe flotacionit te „TREPÇES“ lidhur me studimin per hapjen e nje galerije me qellim qe te behet grumbullimi i ujit tek pjesa e siperme tek 40 burimet.
- ✚ Takim me perfaqsusite ZRRUK-ut lidhur me nenshkrimin e nje marrveshje per plotsimin e standarteve per furnizim me uje per lagjen e Dardanis me qellim qe lirohemi nga performanca per 600 konsumator të kësaj lagje.
- ✚ Eshte nenshkuar Marrveshja me perfaqesuesit e fshatit Kushnin nga HRJ dhe nga Kryetari i Komunes se Prizrenit si dhe jemi te pregaditje te marrveshtjes mes qytetarve te fsh.Kabashë per te kaluar nën menagjimin e Hidroregjionit jugor.
- ✚ Me kerkesen e firmes NPT „ART-COM“ per hulumtimin e prodhimit te energjis elektrike me vendimin e bordit i lejohet firmes „art-com“ te ben kyqjen ne gypat e ujit per te hulumtuar prodhimin e energjisë elektrike dhe pas hulumtimit do te paraqet firma nje raport te gjendjes reale per prodhim te energjisë elektike.

- ✚ Ne muajin Shkurt nga MZHE jan nenshkruar dy marrveshtje per te financuar projektin per ndertimin e rezervarit tek „Pusi Atit“ me shumen prej 500 mijë euro, si dhe eshte nenshkruar edhe marrveshtje per rrugen e „Muhagjerve“ me shumen prej 119 mijë euro ku departmenti teknik ka pregaditur komplet dokumentacioni lidhur me keto dy projekte.
- ✚ Sa I perket projektit te fshatit KOBAJ “Reduktimet e humbjeve per fshatin KOBAJ DMA ZON” te investuar nga K-WISER, eshte perfunduar projekti kryesor per implementim e ketije projekti, Kompania fituese ka rregulluar lejet perkatese per fillimin e punimeve dhe punimet kan filluar me 26.09.2012, dhe projekti ka perfunduar ne tersi edhe me kycjeve shtepiake, andaj pritet se shpejti te behet edhe pranimi teknik me komisionin e perber nga tri palet.. Ky projekt është investuar nga USAID dhe nga K. Prizrenit shuma e perafert eshte rreth 160.000.00 euro, ku prej kesaj shume Komuna e Prizrenit ka investuar 50,000.00 Euro dhe ka bere pagesen ne baze te marreveshitjes se paraparë.
- ✚ Jemi në fazen e perfundimit i punimeve në fsh. Mushtisht ku ekipet tona per montimin e ujmatsve kan punuar pa nderpreje dhe se shpejti pritet te perfundojn punet lidhur me projektin ne fjalë.
- ✚ Sa i perket Projektit Grumbullimi dhe Trajtimi i Ujerave te Zeza tani me jemi ne fazen e perpilimit te konceptit kryesore ne lidhje me Fillimin e projektit Detal, Kompania P2M dhe ajo Vendore Alb-Architect jane vendosur ne Objektet e HRJ-se dhe ne bashkpunim me Stafin Teknik te HRJ-se jane duke u grumbulluar informacione teknike dhe administrative te cilat do te ndikojne ne mbarevajtjen e projektit. *(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi).*
- ✚ Ne muajin Mars eshte bere fillimi i shpimit te puseve ne fsh.Sallagrazhd per qytetaret e komunes se Suharekes, deri me tani jan shpuar katër puse dhe se shpejti pritet te behen shpuarjet edhe te puseve tjera me qellim qe furnizim me uje te jet mjaftushum edhe per fshatrat per rrethë.
- ✚ Në muajin Mars janë bë leximet e ujmatsve zonal me qellim per te verifikuar hargjimet e ujit neper zonat e veqanta dhe prej tyre tre ujëmatsa zonal nuk janë ne gjendje te bejn lexim te drejt,andaj eshte njoftuar firma pergjegjse per te riparuar ujmatsit.
- ✚ Jane pergaditur komplet dokumentacionet per aplikmin e lejes Ujore pran MMPH, me çrast dhe jane dorezuar Aplikacionet ne Depertamantin e Ujerave, presim pergjegje nga Departamenti perkates. Edhe ne muajin Mars te vitit 2013 nuk eshte leshuar Leja Ujore nga Departamenti i Ujerave prane MMPH ne Prishtine.
- ✚ Takim me perfaqesusin e Komunes se Mamushes per realizimin e projektit per shpimin e puseve si dhe vendosjen e trafos per furnizim me energji elektrike, si dhe nga perfaqesusi i komunes se Mamushes jemi informu se TIK-u ka zotuar shumen prej 90 mije euro per kete projekt. Deri me tani nuk asnje gje konkrete ne lidhje me financimin e ketije projekti. Sa i perket performancave ne aspektin Teknik ne Mamushe nuk kemi asnje permiresim.

- ✚ Takim me perfaqsesit te komunes së Prizrenit, Suharekës si dhe te CDI-së lidhur me investimet per një periudhë afat gjate.
- ✚ Departmenti teknik ka bërë të gjitha pregaditjet për të zgjidhur problemin e ujit të pijes për qytetin e Prizrenit dhe ka bërë projekte ideore dhe shumen e perafert , me qellim qe keto projekte ideore ti prezentohen ne nje te ardhem asambles komunale ne Prizren

2.2 Aktivitetet e Shërbimit Teknik për eliminimin e humbjeve teknike

- ✚ Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale,
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit te vjetër te qytetit për eliminimin e humbjeve teknike,
- ✚ Sensibilizimin e te gjithë konsumatorwve pwr mos keqpwrдорim tw ujit tw pijes pwrmes informatave mediale dhe etyre tw shkruara,
- ✚ Ngritjen e vetedijes te te gjithë konsumatoreve qe ta paguajn ujin ne menyre qe te rritet inkasimi dhe te kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve ne sherbime dhe investime per sherbim sa me efikas te furnizimit me uje te pijes.

2.3 Planifikimi I investimeve emergjente

- ✚ Implementimi i pjeses se pare dhe te dyte te Fazes se Dyte te projektit kryesor „40 Burimet“ i cili parasheh:
- ✚ Ndertimin e Komores ujembledhese dhe injektimin e sasise se re te ujit te pijes ne rrjetin distributiv te qytetit te Prizrenit. Eshte perpiluar projekti ideor i ndertimit te galerise percjellese dhe ndertimi i komores kryesore i cili per tu realizuar arrin vleren e perafert prej rreth 180,000.00 Euro, dhe hulumtimi dhe kaptimi i burimeve ekzistuese ne afersi te kaptazhes se IV-te i cili kap vleren prej 220,000.00 Euro. Pas takimit me perfaqesuesit e KfW-se ka kaluar projekti i Eficiences ne energjine elektrike qe perfshine edhe nderrimin e gypave kryesor nga 40 Burimet deri te rezervoari „SHPATI“ ne Prizren.
- ✚ Hulumtimi i ujit ne zonat e larta kryesisht ne fshatin Leskovec, me qellim te mbulimit me furnizim te laxhes TUSUZ dhe se shpejti pritet te behen takime edhe me perfaqsesit e lagjes per te gjetur mundsine e furnizimit me ujë të pijes.
- ✚ Vendosjen e linjes se veçante nga Marashi deri tek ETC-ja qe parashe ndarjen e zonave te furnizimit. Ndarjen e furnizimit te fshatrave dhe laxhes Bajram Curri nga rrjeti furnizues i qytetit, nga departamenti teknik eshte hartuar projekti i cili kap vleren e perafert prej 196,000.00 Euro.
- ✚ Kompania HIDROREGJIONI JUGOR ne Planin e Biznesit dhe ne Strategjine Zhvillimore ka planifikuar edhe planin afatgjate te investimeve per ujesjelles dhe kanalizim.
- ✚ Ne bashkpunim me K. e Prizrenit kemi hartuar planin investiv per uje dhe kanalizim ne te cilin kemi paraqitur planin dhe dinamiken e perfundimit te ketyre punimeve me

te cilat planifikojme te zgjidhim perfundimisht furnizimin 24 oresh me uje te pijes per te gjithë konsumatoret e regjionit te Prizrenit ku kjo Kompani i mbulon.

- ✚ Zgjerimi i veprimatrise se Kompanise per marrjen e sistemeve Rurale nen menaxhimin e HRJ-se.Kompania ka perpiluar hartat me mbulueshmeri te cilat i bashkangjiten ketije raporti.
- ✚ Menaxheri Teknik ka perpiluar planin e investimeve per vitin 2013, 2014 dhe 2015 dhe eshte i gatshem qe kete plan ta prezantoje para Kryeshefit dhe menaxhmentit te larte, plani eshte bere ne periudhen perkatese dhe ka vend per permiresime, prandaj dhe propozon qe te degjohet plani i investimeve ne Plan Biznes.

2.4 Furnizimi me ujë të pijes në Njësitë Punuese

Tabela-1.

Prodhimi i ujit - m3 - Janar - Mars – 2013

Muaji	Prodhimi tre mujor m³	Prodhimi ditor- m³	Prodhimi (l/sec)
Prizren	3,676,805	40,853.00	473
Suharekë	453,982	5,044.00	58.
Dragash	103,574	1,151.00	13.
Malishevë	323,040	3,589.00	42
Total	4,557,401	50,637.00	586

2.5 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve

Tabela-2.

Defektet - Janar - Mars – 2013

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	273	222	495
Suharekë	49	11	60
Dragash	15	0	15
Malishevë	27	33	60
Total	364	266	630

- Sektori i operatives është mirë i organizuar dhe i mobilizuar. Deri më tani ka arrit që defektet e paraqitura në rrjetin e ujësjetësit dhe kanalizimit ti evitojë me kohë.
- Jemi ne pergaditje te planit per ndarje te sherbimit te ujit nga kanalizimi.

	Prizren Total -Gjithësej	Total
1	Blombim-Kontrata	579
2	Dera Mbyllyr(Heren e dyte)	1068
3	Pa Regjstruar	58
4	Zevendsime	80
5	Pa Ujematës	181
6	Rekorde treja per blockmapping	252

2.6 Servisimi i ujëmatësave

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipen e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit. Ky shërbim bënë servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Tabela- 4.

Servisimi i Ujëmatësave -Janar - Mars - 2013

Njësia Operative	Profili \varnothing mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	176	Prej dates 12.03 – 17.03.2013, dy ekipe të demont.-montimit të ujëmatësave janë angazhuar në montimin e ujëmatësave në fsh.Mushtisht. Kurse prej datës 18-31.03.2013, është angazhuar vetëm një ekip i demontim-montimit të ujëmatësave.
	3/4"	210	
	1"	30	
	5/4"	0	
	6/4"	0	
	Gjithsejt:	416	
Suharekë	1/2"	0	
	3/4"	6	
	1"	0	
	Gjithsejt:	6	
Dragash	1/2"	7	Shtatë ndrrime dhe tri montime
	3/4"	35	
	1"	2	
	Gjithsejt:	44	
Malishevë	1/2"	2	3 ujëmatës të ndërruar,si dhe 14 ujëmatës të financuar me vetëfinancim
	3/4"	40	
	1"	0	
	Gjithsejt:	42	

Totali: 508 copë

2.7 Zyra për planifikim dhe zhvillim

Për periudhën që po raportojmë në kuadër të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në terren kanë vazhduar blombimet nëpër qytetin e Prizrenit për të kryer refreshimin këto kanë arritur këto rezultate.

- Ujematësa të bllobuar 561 Ujematësa.
- Kontrata të nënshkruar 561 Kontrata
- Konsumatorët që ekipa jonë nuk ka pasur qasje 1068 konsumator, kjo mosqasje është përcjellë nga ekipa dhe herë pas herë janë vizituar deri sa kanë arritur të kenë qasje.
- Konsumatorët që ekipi konstaton që duhet të zavëndsohet ujematësi janë 80 Konsumator.
- Konsumatorët cilat për shkak kushteve teknike janë 4
- Konsumatorët pa ujematës 101
- Konsumator të paregjistruar 58
- Rekorder treja për blockmapping 252

AKTIVITETET KRYESORE

- Në zyrën e GIS-it gjithsej janë 54 harta të cilat prej tyre 16 janë importuar edhe janë nderlidhur me fakturim, 11 janë vizatuar prej terrenit, edhe 9 janë malore të cilat nuk ka nevojë për vektorizim dhe 26 janë harta të cilat ende nuk janë vizatuar.

Hartat e importuara me lidhje uji në programin edhe nderlidhura me programin ArcGIS 10	Hartat të cilat duhen të vizatohen prej terrenit	Hartat Malore të cilat nuk ka nevojë të vektorizim	Hartat të cilat janë vizatuar prej terrenit
1.Harta 7F12-11-07	1. Harta 7E12-20-08	1. Harta 7E12-30-11	1. Harta 7E12-20-02
2. Harta 7F12-11-08	2. Harta 7E12-20-11	2. Harta 7F12-12-16	2. Harta 7E12-20-05
3. Harta 7F12-11-09	3. Harta 7E12-20-14	3. Harta 7F12-22-01	3. Harta 7E12-20-17
4. Harta 7F12-11-10	4. Harta 7E12-30-05	4. Harta 7F12-22-04	4. Harta 7E12-30-02
5. Harta 7F12-11-11	5. Harta 7E12-30-05	5. Harta 7F12-22-07	5. Harta 7E12-20-03
6. Harta 7F12-11-12	6. Harta 7E12-30-08	6. Harta 7F12-22-10	6. Harta 7E12-20-15
7. Harta 7F12-11-13	7. Harta 7E12-30-11	7. Harta 7F12-21-09	7. Harta 7F12-20-18
8. Harta 7F12-11-14	8. Harta 7E12-20-06	8. Harta 7F12-21-12	8. Harta 7E12-30-03
9. Harta 7F12-11-15	9. Harta 7E12-20-09	9. Harta 7F12-21-11	9. Harta 7E12-30-06
10. Harta 7F12-11-16	10. Harta 7E12-20-12		10.Harta 7E12-30-09
11. Harta 7F12-11-17	11. Harta 7E12-30-12		11.Harta 7E12-12-04
12. Harta 7F12-11-18	12. Harta 7F12-11-01		
13. Harta 7F12-21-01	13. Harta 7F12-11-04		
14. Harta 7F12-21-02	14. Harta 7F12-21-07		
15. Harta 7F12-21-04	15. Harta 7F12-21-10		
16. Harta 7F12-21-05	16. Harta 7F12-11-02		
	17. Harta 7F12-11-05		
	18. Harta 7F12-21-08		
	19. Harta 7F12-11-03		
	20. Harta 7F12-11-06		
	21. Harta 7F12-21-03		
	22. Harta 7F12-21-06		
	23. Harta7F12-12-01		
	24. Harta 7F12-12-07		
	25.Harta 7F12-12-10		
	26.Harta 7F12-12-13		

- Gjatë këtij tre mujorit është punuar në vendosjen e ujëmatësave në fshatin Mushtisht komuna e Suharekës, ku gjatë punëve kanë marrë pjesë 4-5 grupe.
- Punët kanë filluar ku deri me tani janë bërë 253 kontrata (vendosje të ujëmatësave) dhe pritet se shpejti të perfundon vendosja e ujëmatësave në tërë fsh. Mushtisht si dhe të fillohet me fazat e metutjeshme të punës.
- Ekipet e detektimi të rrjetit të ujësjellësit kanë bërë gjithësej 78 detektime, gjatë detektimeve kanë hasur në 54 defekte (rrjedhje nëntokësore), Ekziston raporti i veçanët.
- Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësve zonal, ku tre ujëmatës zonal nuk bëjnë lexim të rregulltë ku një prej ujëmatësave zonal është riparuar dy herë priten që të riparohen edhe dy ujëmatës zonal nga CMC-ja.
- Janë bërë vizita në teren në fshatin Kobaj, arsyja mbikqyrja dhe monitorimi i projektit "Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjellësit Kobaj" dhe se shpejti pritet të bëhet edhe pranimi teknik nga nënshkruesit e marrëveshtjes për financim.

2.8 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike

Gadi gjatë tërë muajit jemi marrë me kompletimin e laboratorit ku me ç'rast të gjitha paisjet I kemi vendosur në vendet e veta si dhe kemikatet që kanë arrijtur në disa intervale;

-Kemi kontaktuar dhe kemi arritur që të angazhojmë personat që kanë qenë të zgjedhur të bëjnë trajnimin e stafit për analizat Fiziko-Kimike dhe atë Bakteriologjike;

-Gjatë muajit tre ditë kemi vizituar ISHP-Prizren, ku kemi bërë trajnimin për analizat fiziko-kimike me stafin përkatës të tyre Muhamed Domuzeti, kurse dy ditë tjera analizat e njëjta kemi bërë në laboratorin tonë;

-Për shkak të mungesës së një pjese për analiza bakteriologjike nuk kemi mundur që menjëherë të vazhdojmë në kontinuitet edhe këto analiza (bakteriologjike), kështu që në marrëveshje me furnizuesin dhe me Prof. përkatës për trajnim jemi dakorduar që pasi që të sigurojmë pjesën e duhur menjëherë të qasemi trajnimit. Pasi që pjesa e lartpërmendur është siguruar jemi dakorduar që pjesën e analizave bakteriologjike të fillojmë më 24.04.2013 me asistimin e prof. Kemajl Kurteshi që është përcaktuar për trajnim;

-Disa herë janë marrë mostrat për analiza në burimin Sallagrazhdë me përfaqësues të ISHP-së;


-Janë bërë riparime në stacionin e klorifikimit në Bunarllëk I (eliminimi I defekteve në aparatet për klorifikim) dhe në Mulli;

-Përcjellja e gjendjes së furnizimit në pika të ndryshme të furnizimit dhe sasinë e klorit Rezidual si dhe kompletimin dhe evidentimin e rezultateve.

Tabela -5.

Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike – Janar-Mars 2013

Muaji	Nr. Total	Biologjike			Kimike		
		Nr. Total	Pergj.	nuk I pergj.	Nr. Total	Pergj.	nuk I pergj.
JANAR	144	101	101	0	43	42	1
SHKURT	152	106	105	1	46	46	0
MARS	172	120	117	3	52	52	0
Total	468	327	323	4	141	140	1
% e Deshtimeve				1.2			0.7
% e Desht. Total							1.1

**III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË****3.1 Aktivitetet**

- Në fund të këtij tremujori në nivel rajonal janë shtyp dhe shpërnda te konsumatorët 36,825 fatura, prej tyre: 31.850 amvisëri , 4.394 biznese dhe 581 institucione. Ne kete tremujor në krahasim me tremujorin e katërt 2012 muajin paraprak kemi 599 fatura te leshuara me teper. Në këtë tremujormujor ka fillu edhe shtypja e faturave për fshatin Luginë e Hasit (259 fatura) ndërsa pjesa tjetër nga kjo diferencë është rezultat pëlqimeve për kyqje të re dhe i identifikimit dhe legalizimit të konsumatorëve ilegal nga ekipet e kontrollës dhe rezultat i pëlqimeve për kyqje në shërbim të ujësjellsit dhe kanalizimit. Ne fund te muajit shkurt Mamusha me numër te konsumatorëve dhe të dhëna tjera tjera janë bart nga Njësia e Suharekës në Njësin e Prizrenit. Andaj, të dhënat në raportet e Njesisë së Suharekës janë të minusuara

për Mamushën dhe të njejtat të dhëna janë të raportuara në Njësin e Prizrenit në këtë tremujor..

- Gjatë këtij tremujori janë faturuar 1.797.185m³ ujë të ndarë në këto kategori: amvisëri: 1.461.564 m³, biznese: 131.341 m³ dhe institucione 204.280 m³ ujë. Nëse e krahasojmë me tremujorin e katert 2012 kemi një ne faturim më të vogël prej 128.485 m³, ndërsa nëse krahasohet me tremujorin e njejtë të vitit paraparak kemi një rritje në faturim për 141.963 m³. Rënia vjen si rezultat i konsumit më të vogël në këtë tremujor. Në krahasim me tremujorin paraparak rënie kemi te të tri kategoritë e konsumatorëve (te amvisëria – 60.169m³, te bizneset - 21.271 m³ dhe te institucionet – 47.045 m³).
- Përcjellja dhe kontrolli i punëve të inkasimit, kontrollës dhe ç'kyçjes në kuadër të KRU „Hidroregjioni Jugor“ sh.a., në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive. Gjatë këtij tremujori në nivel rajonal nga ekipet e kontrollës janë vizitu 3.714 konsumatorë, janë regjistru 297 konsumatorë (lidhje të reja dhe konsumatorë ilegal) të cilët bazuar në procedurat e mbrendshme janë legalizuar konsumatorët ilegal ndërsa janë shkyq 67 lidhje ilegale të cilët janë shkyq menjëher, dhe janë me një paushall për periudhën e kaluar që e kanë keqpërdor ujin .Nga këto ekipe në nivel rajonal janë inkasu 53,527.91 euro nga konsumatorët që kanë borgj mbi 400 euro. Ne periudhën e njejtë të vitit 2012 janë inkasu 48,263.83 që dmth që kemi një rritje prej
- Në nivel rajonal kemi pranë dhe shqyrtu 557 ankesa të konsumatorëve prej tyre:
 1. 337 ankesa teknike- detektive, mungesë të ujit, riparime të rrjedhjeve, deblokime të kanalizimeve.
 2. 220 ankesa komerciale- ankesa rreth faturimit paushall të rritur, kontestim i faturave etj.
- Në bashkëpunim me shërbimin teknik janë formu ekipet për vendosje të ujëmatësve.
- Te konsumatorët tek të cilët nuk ka mundësi teknike të shkyqjes (si psh ndërtesat kolektive) në këtë tremujor janë shpërnda 1179 Njoftime para Padisë, ku nga ky numër kemi diku 70 konsumatorë që kanë bërë riprogramimin e borxhit.
- Vazhdim i aksionit për njoftime për shkyçje te konsumatorët që:
 - Kanë borxhe mbi 400 euro dhe nuk i përgjigjen pagesës dhe riprogramimit të borgjit. Janë ndërru terrenet e inkasantëve në mënyrë që të përfshihen numër më i madh i konsumatorëve.
 - Kontrollë rreth eliminimit te keqperdorimeve te ujit si : kontrole permanente te konsumatoreve që kanë lidhje jashtë ujëmatësit (ç'kyçjet e tyre), intensifikimi i aktiviteteve edhe pas orarit të punës dhe ditëve të vikendit.

- Pjesmarrje në takimet mujore në Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ku pjesmarrës në këto takime janë zyrtar nga ZRRUM dhe përfaqësues nga Kuvendet Komunale të zonës së operimit të KRU „Hidroregjioni Jugor“sh.a.

Tabela- 6.

Raport I ekipes së Kontrollës dhe shkyçjes

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Shkyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve	Inkasimi nga Kontro.
1	Prizren	170	13	11	2460	48,067.24 €
2	Suharekë	112	47	19	892	1,890.00 €
3	Malishevë	15	7	6	362	3,570.67 €
4	Dragash	0	0	0	0	0.00 €
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	297	67	36	3714	53,527.91 €

Tabela- 7.

Raport I ankesave

MUAJI	JANAR	SHKURT	MARS	TOTAL
ANK. TEKNIKE	153	82	102	337
TË SHQ.	150	82	102	334
ANK. KOMER.	57	86	77	220
TË SHQ.	57	86	74	217
TOTAL	210	168	179	557




Tabela-8.**Faturat e lëshuara sipas kategorive të konsumatorëve**

MUAJI	JANAR	SHKURT	MARS	JANAR-MARS
Amvisnit	31,375	31,783	31,850	31,850
Bizneset	4,363	4,385	4,394	4,394
Institucionet	581	585	581	581
Totali	36,319	36753	36825	36825
Rritja		434	72	506

Tabela-9.**Uji I faturuar m3 sipas kategorive**

MUAJI	JANAR	SHKURT	MARS	TOTAL
Amvisnit	502,425	484,716	474,423	1,461,564
Bizneset	49,011	41,371	40,959	131,341
Institucionet	73,889	64,633	65,758	204,280
TOTAL	625,325	590,720	581,140	1,797,185

3.2 Aktivitetet e shërbimit për informim

Një nga qëllimet kryesore të KRU-“Hidroregjioni Jugor”, (përveç furnizimit me ujë dhe inkasimit, mirëmbajtjes së rrjetit, etj.) është edhe që ta informojë opinionin publik, gjegjësisht konsumatorin për të gjitha ngjarjet që ndodhin në Kompani apo për problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet kompania, gjithashtu ta informojë konsumatorin me kohë shpejtë dhe saktë për pengesat, ndërprerjet në furnizim apo defekte të ndryshme.

Media - Janar

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI	KOMENTE
1	05.01.2012	KOSOVA SOT	PRONONCIM RRETH INVESTIMEVE	
2	15.01.2013	TV-BESA TV-OPINION	NJOFTIM LIDHUR ME MUNGESËN E UJIT NË DISA FSHATRA	
3	15.01.2013	RADIO AVAZO	INFORMATË LIDHUR ME NUMRIN E TË PUNËSUARVE	
4	15.01.2013	KOHA DITORE	SHAJNA NJË JAVË PA UJË	
5	18.01.2013	KOSOVA SOT	ZGJEROHET RRJETI I UJËSJELLËSIT	
6	23.01.2013	TV-BESA	EMISION I DREJTËPËRDREJTË	
7	24.01.2013	TV-BESA	NË KUADËR TË LAJMEVE - RRETH AKTIVITETEVE TË KOMPANISË	
8	25.01.2013	KOSOVA SOT	PREMTOHET FURNIZIM I RREGULLT ME UJË TË PIJSHËM	
9	30.01.2013	KOSOVA SOT	VIDHET UJI PËRMES LIDHJEVE ILEGALE	
10	30.01.2013	ZËRI	A PO E "VJEDHIN" UJIN BANORËT E THERANDËS?!	
11	30.01.2013	TV-BESA TV-OPINION	NJOFTIM LIDHUR ME REDUKTIMIN E UJIT NË NDËRTESA KOLEKTIVE	
12	31.01.2013	MEDIAT	INFORMATË LIDHUR ME HAPJEN E PUSEVE TË REJA	
13	31.01.2013	www.tv-opinion.com	NDËRTESAT KOLEKTIVE DO TË KENË FURNIZIM ME UJË ME ORAR TË REDUKTUAR	
14	31.01.2013	www.prizrenpress.com	"HIDROREGJIONI JUGOR" NË KËRKIM TË UJIT	

SHKURT 2013

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI	KOMENTE
1	01.02.2013	www.tv-opinion.com	FILLOJNË SHPIMET NË HAPJEN E NJË BURIMI TË RI	
2	01.02.2013	KOHA DITORE	REDUKTOHET FURNIZIMI ME UJË NË BANESAT KOLEKTIVE TË PRIZRENIT	
3	02.02.2013	TV-BESA	NJOFTIM- MUNGESË E UJIT NË LAGJEN TUSUS(DJEGIA E POMPËS)	
4	03.02.2013	TV-BESA TV-OPINION RADIO HELIX	NJOFTIM- MUNGESË E UJIT PËR SHKAK TË DEFEKTIT NË RRJETIN ELEKTRIK TE 40 BUNARËT	
5	05.02.2013	LAJM	NJOFTIM PËR APLIKIMIN E TARIFAVE TË REJA	
6	08.02.2013	TV-BESA TV-OPINION	NJOFTIM- MUNGESË E UJIT PËR SHKAK TË DEFEKTIT NË GYPIN KRYESOR TE 40 BURIMET	
7	09.02.2013	www.tv-opinion.com	RRITJA E NUMRIT TË BANORËVE TË QYTETIT TË PRIZRENIT SHTON DOMOSDOSHMERINË E KËRKIMIT TË BURIMEVE TË REJA TË UJIT TË PIJES	
8	19.02.2013	www.prizrenpress.com	PËRURIMEN PESË BURIME TË UJIT	
9	19.02.2013	RTK	PËRURIMI I PESË PUSEVE	
10	19.02.2013	TV-BESA	PËRURIMI I PESË PUSEVE	
11	19.02.2013	TV-OPINION	PËRURIMI I PESË PUSEVE	
12	19.02.2013	TV-PRIZRENI	PËRURIMI I PESË PUSEVE	
13	20.02.2013	www.tv-opinion.com	PËRURIMEN PESË BURIME TË REJA TË UJIT	
14	20.02.2013	KOSOVA SOT	TE"40 BUNARËT" "HIDROREGJIONI JUGOR" HAP PESË PUSE TË REJA	
15	21.02.2013	LAJM	PRIZRENI, 100 LITRA UJË MË SHUMË NË SEKONDË	
16	22.02.2013	TV-BESA TV-OPINION	NJOFTIM- MUNGESË E UJIT PËR SHKAK TË NDËRPRERJES SË RRYMËS TE 40 BUNARËT	
17	25.02.2013	TV-PRIZRENI	EMISION I DREJTËPËRDREJTË (ORIGJINALE)	
18	26.02.2013	TV-BESA TV-OPINION	NJOFTIM- MUNGESË E UJIT NË SPITALIN REGJIONAL DHE LAGJEN TUSUS,PËR SHKAK TË NJË DEFEKTI	

Media- Mars

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI	KOMENTE
1	05.03.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: MUNGESË E UJIT NË ORTAKOLL,PËR SHKAK TË PLASARITJES SË GYPIT	
2	19.03.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM:PËR SHKAK TË ERËS SË MADHE, ËSHTË ÇRREGULLUAR FURNIZIMI ME UJË	
3	19.03.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA RRUGË, PËR SHKAK TË NJË DEFEKTI NË Rr. SALAJDIN BRAHA	
4	19.03.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: PËR SHKAK TË DEFEKTIT TEK LOKACIONI"ANDRRA", NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË Rr. NËNË TEREZA	
5	20.03.2013	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: PËR SHKAK TË DEFEKTIT NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA RRUGË	
6	20.03.2013	www.tv-opinion.com	PROBLEME ME RRYMË TE 40 BUNARËT	
7	23.03.2013	TV-BESA	NJOFTIM: NË MUNGESË TË RRYMËS TE BUNAR I DHE BUNAR II, MUNGESË E UJIT NË DISA LAGJE	
8	20.03.2013	TV-PRIZRENI	PRONONCIM LIDHUR ME ÇRREGULLIMIN E FURNIZIMIT ME UJË, PËR SHKAK TË ERËS SË MADHE	
9	27.03.2013	TV-OPINION	PJESËMARRJE NË EMISIONIN E DREJTËPËRDREJTË TË MËNGJESIT	

3.3 Pengesat në realizimin e objektivave:

- Vështirësitë në inkasim si rezultat i mospagesës së obligimeve rrjedhëse për shërbimet e ujësjellsit :
 1. Te konsumatorët e amvisërisë- gjendja e rënde ekonomike , ky tremujor i cdo viti për shkak të sezonalitetit kemi më pak të hyra te konsumatorët e si rezultat i kësaj ndikon edhe pagesa për shërbimet e ujësjellsit.
 2. Te bizneset – pamundësia e pagesave rrjedhëse e cila vjen nga rënia e punës në biznese, gjithashtu te një numër i madh i bizneseve kemi të hyra të vogla.
 3. Te konsumatorët insticional –planifikimet e vogla në buxhet te organizatat buxhetore si dhe alokimet buxhetore në periudha tremujore po e pamundësojn pagesën rrjedhëse për cdo muaj te kjo kategori.
- Rritja e numrit të konsumatorëve si raste sociale si dhe rritja e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për ti paguar obligimet ndaj kompanisë.
- Mosfurnizimi i rregullt me ujë në disa zona (reduktime) po ndikojn në inkasim të shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit.

3.4 Planet për të ardhmen:

- Vazhdimi i punës së Task Forcës për inkasimin e mjeteve nga konsumatorët që kanë borgj mbi 400 euro. Shërbimi i Kontrollës dhe Shkyqjes nga Njësia e Prizrenit do të mbështesë edhe ekipet nga njësit si :Suharekë dhe Malishevë, 2-5 ditë mbrenda muajit do të kryejn shkyqje edhe në këto njësi. Këto mbështetje do të bëhen varsisht prej kërkesave të Udhëheqësve të Njesive.
- Rritja e faturimit të matur të ujit, nga shërbimi me konsumatorë do të identifikohen konsumatorët pa ujëmatës dhe në bashkëpunim me shërbimin teknik do të shiqohen mundësit për vendosje të ujëmatësve.
- Kontrolli i vazhdueshëm i keqpërdoruesve të ujit të pijes nga ana e kontrollës. Shtimi i kontroleve te konsumatorët gjatë sezonit veror ku keqpërdorimet rriten tek konsumatorët.

IV. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

4.1.1 Aktivitetet Janar-Mars 2013

Departamenti i administrates gjatë këtij tremujori është marrur me përgaditjen e raportëve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgaditur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dalura nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për hulumtime dhe teknologji, komiteti për staf dhe shperblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Janë përgaditur dhe vazhduar kontratat e punës për 2013, për të gjithë punëtorët e Kompanisë Kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar ne raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marëdhënieve të punës.
- Janë përgaditur dhe shpallur në shtypinë ditorë 9 (nëntë) konkurse për vendet e parapara të punës nga Menaxhmenti i Kompanisë.
- Është bërë ndryshimi i koficentit të disa punonjësve pas kërkesës me shkrim nga udhëheqësit e tyre dhe aprovimit nga Zyrtari Kryesor financiar dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Në Department të Administrates kemi patur auditim nga Auditori i Jashtëm “Kanuni i Auditorit” për vitin 2012 .
- Është përgaditur Libri lidhës për Qeverisjen Korporative për vitin 2012 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbajtja e saj përfshinë :qertifikatën e regjistrimit të Biznesit, Vendimin mbi emrimin e Bordit, procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për 2012, vendimet e Bordit për 2012, procesverbalet e Komisionit të Auditimit, Vendimet mbi themelimin e komitetëve tjera te Bordit ,procesverbalet e komiteteve, plan-biznesi 2013-2015 dhe raporti vjetor 2012.
- Përgaditja e të dhënave të Kompanisë për web-faqe dhe dërgimi i tyre në NJPMNP. Dokumentet e kërkuara janë: Raporti Final i Auditorit të Pavarur të Pasqyrave Financiare 2012; Kontratat e Prokurimit me vlera të mëdha siq e parashikon Ligji i Prokurimit për vitin 2012, Lista për dhjetë furnizuesit më të mëdhenjë për nga vlera në 2012, Rregulloret e miratuara nga BtD gjatë vitit 2012, Deklarata se nuk ka konflikte të interesit të deklaruar gjatë 2012 është kërkuar konfirmimi i Kryesuesit të BtD me anë të një shkrese se nuk ka patur konflikte interesi gjate 2012, Zotimet e Drejtorëve të BtD dhe Zyrtarëve tjerë të NP për respektimin e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative.
- Janë dërguar në NJPMNP Kompenzimet mujore dhe shtesat e tjera të anëtarëve të Bordit dhe kompenzimet mujore të zyrtarëve të lartë, në KRU “Hidroregjioni Jugor” sh.a Prizren për vitin 2012.
- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Univerzitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit, Menaxhimit të burimeve njerzore, Menaxhimit të Projektëve, në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.
- Pjesmarrja në trajnimin e ftuar nga NJPMNP-MZHE me temë: NP komunikimi me Aksionarin dhe Publikun e përgjithshëm.
- Pjesmarrja në grupin punuesë në SHUKOS për hartimin e “Marrëveshjes së Bashkëpunimit” për mbështetjen e Gjqësorit ndaj Kompanive Rajonale të

Ujësjetillësit. Interesat e palëve nënshkruese të këtij Memorandum Bashkëpunimi janë:

SHUKOS-i , në arkëtimin më të mirë të borxheve të cilat do të ndikonin në rritjen e investimeve në ofrimin më të mirë të shërbimeve të ujësjetillësit dhe kanalizimit dhe

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në rritjen e besimit dhe në ngritjen e efikasitetit të Gjykatave.

Tabela-10.

Personeli Janar- Mars 2013

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Verejtje
Janar	274	1	1	0	1 punëtor pushim pa pages 1 punëtor i pensionuar
Shkurt	282	8	2	0	
Mars	284	2	3	0	

Tabela-11.

Numri I punëtorëve sipas nacionaliteteve Janar- Mars 2013

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	228	36	5	15	284
Numri i Punëtorëve në %	80.3	12.7	1.8	5.3	100

Tabela-12.

Numri i punëtorëve sipas gjinisë

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	30	10.56	
MESHKUJ:	254	89.44	
TOTAL	284		

Tabela-13

Kualifikimi i punëtorëve

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa shkollë	Gjithsejë
Nr. i punëtorëve	24	11	6	146	31	50	16	284
Kualifikimi në %	8.45	3.87	2.11	51.41	10.92	17.61	5.63	

Tabela-14.

Raport rreth Punës së Zyrës Ligjore

Padi	Përgjigje në Padi - Revizion	Propozim për Ekzekutim	Seancat përgatitore	Seancat kryesore	Seancat e shtyra	ANKESAT në shkallë të dytë	TOTALI
JANAR 2013	1 Revizion	1	/	/	3	/	5
SHKURT 2013	1 Padi	/	1	4	2	/	8
MARS 2013	2 Padi 1 Padi e tërhykur	/	1	10	2	/	15
Totali	4	1	2	14	7	/	28

4.1.2 Përgjigje në padi apo revizion

1. Është dhënë **PËRGJIGJE NË REVIZION** lidhur me Lëndën **C.nr. 92/11, KONTEST PUNE.**
2. Është dhënë **PËRGJIGJE NË PADI** lidhur me Lëndën **C.nr. 687/11**, Padi ndaj Kompanisë me të cilën kontestohet borxhi nga ana e debitorit
3. Është dhënë **PËRGJIGJE NË PADI** lidhur me Lëndën **C.nr. 835/08**, Padi ndaj Kompanisë me të cilën kërkohet dëmshpërblim nga Kompania pasi që Paditësit kanë pësuar lëndime,
4. pasi që nuk është siguruar vendi ku janë kryer punimet pas defektit në rrjetin e ujësjellësit tek ish Shkolla e Lartë në Rr. Ismet Jashari-Kumanova.

4.1.3 Padi nga Kompania

1. Për Lëndën **C.nr. 189/2010**, është përgatitur për dërgim në Gjykatën Themelore në Prizren – Dega në Suharekë PROPOZIM PËR LEJIMIN E EKZEKUTIMIT për borxhin e shkaktuar me dëm nga Debitorit.

4.1.4 Kërkesë e gjykatës themelore per ekzekutim

1. Për lëndën **C.nr. 603/09**, me të cilën kërkohet që të bëhet ekspertiza e të ardhurave personale të Paditsit lidhur me kompensimin eventual të të ardhurave personale.

4.1.5 Vendimet ne favor te Kompanisë nga ana e gjykatës themelore në Prizren

1. Për lëndën **C. nr.842/06**, ka ardhur **AKTGJYKIM** me të cilin aprovohet kërkesëpadia e Kompanisë lidhur me pagesën e borxhit në lartësinë prej **1.202.00 Euro** nga ana e Debitorit.
2. Për lëndën **C. nr. 793/10**, ka ardhur **AKTGJYKIM** me të cilin aprovohet kërkesëpadia e Kompanisë lidhur me pagesën e borxhit në lartësinë prej **388.30 Euro** nga ana e Debitorit.

4.1.6 Lëndë të kryera përfundimisht

1. Është kryer Lënda **C.nr. 766/05**, pasi që Paditësi e ka paguar në tërësi borxhin e tij në shumën prej **240.06 Euro** ndaj Paditësit respektivisht Kompanisë sonë.
2. Për Lëndën **C.nr. 803/11**, PADI, është tërhequr Padia e ish punonjësit të Kompanisë për KONTEST PUNE me kërkesë për kthim në punë.
3. Për Lëndën **C.nr. 71/10**, PADI, është tërhequr Padia e punonjësit të Kompanisë për KONTEST PUNE me kërkesë për kthim në punë, pasi që i njëjti ndodhet aktualisht me punë në Kompaninë tonë.

4.1.7 Në pritje të vendimeve gjyqësore për lëndët e përfunduara

1. Për Lëndën **C.nr. 774/11**, KONTEST PUNE, është mbajtur seanca kryesore Gjyqësore dhe tani jemi në pritje të vendimit nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me Vendimin që e njëjta do ta marrë.
